

Resurset e Rajonit

Rajoni i Korçës është një nga qendrat më të mëdha dhe më të zhvilluara të Shqipërisë. Ai shquhet për nivel të lartë zhvillimi në fushën ekonomike dhe tregëtare, kjo kushtëzohet nga një sërë faktorësh:

- Pozita Gjeografike
- Kushtet Klimaterike
- Flora
- Fauna
- Burimet Ujore
- Burimet Nëntokësore

BURIMET UJORE

Qarku i Korçës përfshin në territorin e vetëm dy liqene të rëndësishëm:

- Liqenin e Prespës, me një sipërfaqe të përgjithshme të pasqyrës së ujit rreth 329 km² (Prespa e Madhe me 285 km² dhe Prespa e Vogël me rreth 44 km²). Thellësia 54 m dhe me vëllim ujrash rreth 5,2 miliard m³ ujë.

–Liqenin e Pogradecit (Ohrit), me një sipërfaqe prej 363 km², ku rreth 111,4 km² shtrihet brenda territorit të Shqipërisë, thellësi mesatare 145 m e thellësi maksimale 295 m. Vëllimi i ujërave është rreth 50 miliardë m³ ujë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është rreth 2800 km². Rajoni i Korçës laget nga liqene, lumenj dhe përrenj të ndryshëm:

- Liqeni i Ohrit
- Liqenet e Prespës së Madhe dhe të Vogël
- Lumi i Devollit
- Lumi i Dunavecit

BURIMET NËNTOKËSORE

Zona e Korçës është e pasur me burime nëntokësore të tipit metalor dhe jo metalor .

- *Metalorë*: bakër, hekur nikel, krom, dhe nikel silikat
- *Jo metalorë*: gur talku, asbest, rërë kuarcorë.
- *Jo metalorë energjitike*: qymyrguri
- *Jo metalorë* (materiale ndërtimi dekorative) argjila për tullë, gurë gërqeror për ndërtim, guri i kuq i Polenës, guri i shtufit, zhavorë, rëra për beton etj.

Burimet nëntokësore të zonës së Korçës janë nga më të rëndësishmet në Shqipëri dhe shfrytëzimi me efikasitet i tyre do të jetë një burim i mirë të ardhurash për zhvillimin e rajonit.

Biodiversiteti

Biodiversiteti i Qarkut të Korçës është mjaft i larmishëm dhe përfaqësohet nga një botë e pasur bimore dhe shtazore. Sipërfaqja pyjore llogaritet në 133 760 ha, e cila sipas katizimit vertikal përbëhet nga pyjet e dushkut, ahut, pishës (pisha e zezë) dhe bredhit. Për t'u përmendur është prania e bimëve mjeksore dhe aromatike si sherebela, çaji i malit, bliri, lulkuqja etj., mbledhja dhe tregtimi i të cilave është konsideruar, në disa zona, si mundësi për sigurimin e jetesës së banorëve (treva e Kolonjës).